



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 97, datë 04.08.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË**  
**VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 496, DATË 30.07.2021 “PËR**  
**MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË DURRËS PËR MBËSHTETJE**  
**FINANCIARE NGA QEVERISJA QËNDRORE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE”**

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, VKM nr. 438, datë 15.07.2021 “Për mbështetjen financiare për menaxhimin e mbetjeve në Bashkitë e Qarkut të Durrësit”, VKM nr. 496, datë 30.07.2021, “Për miratimin e kërkesës së bashkisë Durrës për mbështetje financiare nga qeverisja qendrore për menaxhimin e mbetjeve”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”, Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjit nr.10431, datë 09.07.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, VKM nr.967, datë 25.10.2013, pika 4/c “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, VKM nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e Dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, VKM nr. 389, datë 27.06.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 452, datë 11.07.2012 "Për Lendfillet e mbetjeve", Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 06, datë 13.01.2020 “Për miratimin e lejes së infrastrukturës: “Mbyllja e vendepozitimit të

mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i ECO-PARK me vendndodhje në Bashkinë Durrës”, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Vendimit nr.06, datë 25.05.2021 të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Vendimit nr. 03, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 68, datë 10.06.2021 “Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimin nr. 06, datë 25.05.2021 të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, dhe Vendimin nr. 03, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Ndërmarrjet e Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,



**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondeve si më poshtë:

A. Fondet për depozitimin e mbetjeve në landfill dhe burimi i financimit të tyre sipas tabelës nr.1:

Tabela nr.1

Në lekë

PBA	Periudha	Fondi për depozitimin e mbetjeve në landfill	Burimi i financimit			
			Bashkëfinancimi nga Bashkia (transferta e pakushtëzuar)		Transferta specifike për menaxhimin e mbetjeve nga Buxheti i shtetit	
			Në %	Në lekë	Në %	Në lekë
1	2	3	4	5	6	7
	2021 (gusht -dhjetor)	114,886,400	0%	-	100%	114,886,400
PBA 2022 -2024	2022	344,659,200	10%	34,465,920	90%	310,193,280
	2023	344,659,200	10%	34,465,920	90%	310,193,280
	2024	344,659,200	10%	34,465,920	90%	310,193,280
PBA 2025 - 2027	2025	344,659,200	15%	51,698,880	85%	292,960,320
	2026	344,659,200	15%	51,698,880	85%	292,960,320

	2027	344,659,200	15%	51,698,880	85%	292,960,320
PBA 2028 - 2030	2028	344,659,200	20%	68,931,840	80%	275,727,360
	2029	344,659,200	20%	68,931,840	80%	275,727,360
	2030	344,659,200	20%	68,931,840	80%	275,727,360

B. Fondet për shpenzime dhe infrastrukturë të transportit nga kufiri i NJQV (në të ardhmen stacion transferimi i mundshëm) në landfill dhe burimi i financimit të tyre sipas tabelës nr.2:

Tabela nr.2

Në lekë

PBA	Periudha	Fondi për shpenzimeve dhe infrastrukturë të transportit	Burimi i financimit	
			Bashkia Durrës	Transferta specifike për menaxhimin e mbetjeve nga Buxheti i shtetit
1	2	3	4	5
2021	2021 (gusht - dhjetor)	39,950,000	-	39,950,000
PBA 2022 -2024	2022	119,850,000	-	119,850,000
	2023	119,850,000	-	119,850,000
	2024	119,850,000	-	119,850,000
PBA 2025 -2027	2025	119,850,000	-	119,850,000
	2026	119,850,000	-	119,850,000
	2027	119,850,000	-	119,850,000
PBA 2028 -2030	2028	119,850,000	-	119,850,000
	2029	119,850,000	-	119,850,000
	2030	119,850,000	-	119,850,000

2. Fondet për periudhën gusht-dhjetor 2021 të paraqitura në tabelën nr.1 dhe tabelën nr.2 do të merren nga transferta specifike, që alokohet nga buxheti i shtetit në mbështetje të pikës 3 të VKM nr. 496, datë 30.7.2021.

3. Për vitet 2022-2030 shuma e mbështetjes financiare për menaxhimin e mbetjeve, e paraqitur në tabelat nr.1 dhe nr.2, negociohet çdo vit fiskal gjatë hartimit të projektbuxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkisë Durrës, në varësi të aftësive fiskale.
4. Për vitet 2022-2030 shuma e mbështetjes financiare për menaxhimin e mbetjeve, e paraqitur në tabelat nr.1 dhe nr.2, do të jetë pjesë e dokumentit të Programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor të Bashkisë Durrës.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Drejtoria Ekonomike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**ZËVENDËSKRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**

**Zamira Mustafaraj**



**U shpall sot me datë 05.08.2021**

BASHKIA DURRES  
Dt. 05. 08. 21. Nr. 612/2 PROT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 612/2 Prot.

Durrës, më 05.08.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 97 datë 04.08.2021  
“ Për miratimin e përdorimit të fondit të përfituar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 496, datë 30.07.2021 “Per miratimin e kërkesës së Bashkisë Durrës për mbështetje financiare nga qeverisja qendrore për menaxhimin e mbetjeve.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016  
“ Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ROLAND NASTO